



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMIT

Nr. 48 Prot

Tiranë, më 24.10. 2006

VENDIM Nr. 7 dt. 16.10.2006

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimit në mbledhjen e datës 16.10.2006, pasi shqyrtoi projektet e miratuara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës

VENDOSI:

I. Miratimin e projekteve të restaurimit:

- a) Restaurim Kalaja e Elbasanit.
- b) Restaurim i pareklisit të Manastarit të Shën Kozmait, Kolkondas – Fier. (Vazhdim).
Nuk u miratuan pikat 9 dhe 10 të ndërhyrjeve për të cilat duhet të paraqiten projektet përkatëse që pikërisht janë:
 - 9) Rivendosja e afreskut të Shën Kozmait.
 - 10) Konservimi i pikturës murale të kishës së Shën Marisë, e cila do të mbrojë nga lagështia jo vetëm muraturën dhe pikturën e kishës së Shën Marisë, por dhe murin jugor të pareklisit të Shën Kozmait, ku do të rivendoset afresku me përfytyrimin e shenjtit.
- c) Kullë vrojtimi e periudhës mesjetare (Vlorë).
Projekti duhet të plotësojë këto kërkesa:

Bazamenti i ndërtimit mesjetar të ruhet në tërësinë e tij, duke lejuar ndërtim të ri përreth dhe mbi të, duke respektuar nenin 32, të Ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore". Ndërtimi i ri nuk duhet të çënojë volumin e monumentit, i cili do të jetë i vizitueshëm. Për soditjen e monumentit të sigurohet një hapësirë e mjaftueshme në brendësi të ndërtimit të ri. Punimet do të jenë nën supervizionin e IMK.
- d) Projektin e restaurimit të çatisë së kishës së "Shën Ilias" Voskopojë, Korçë.
- e) Projektin e Qendrës Historike Shkodër.

II. Miratimin e rregullores së kriterëve të liçensimit në fushën e Trashëgimisë Kulturore.

III. Miratimin në unanimitet të heqjes nga lista e Monumenteve të Kulturës të atyre objekteve, që lidhen me ngjarje dhe figura të veprimtarisë së Partisë Komuniste Shqiptare dhe nuk kanë vlera arkitekturore. Bazuar në nenin 31, pika 2, të ligjit nr.

9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i propozon Ministrin të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve heqjen e tyre nga lista.

Si më poshtë vijon:

Tiranë

1. Zona përreth ish shtëpisë së Partisë.
2. Shtëpia muze ku u themelua Partia Komuniste.
3. Shtëpia muze ku u shtyp Zëri i Popullit.
4. Shtëpia muze e Xha Dyrut, Pezë.
5. Shtëpia e ish Dalip Karajt. Alltatë – Baldushk.
6. Shtëpia muze e Abdulla Ketës.
7. Shtëpia muze e Zeqi Agollit.
8. Shtëpia e Sabaudin Gabranit.
9. Shtëpia e Halil Shyrit.
10. Shtëpia e Ije Farkës.
11. Shtëpia e Esat Dishnicës.
12. Shtëpia e Xhezmi Dellit.
13. Shtëpia e Riza Dashit.
14. Shtëpia e Thoma Kokushtës.
15. Shtëpia e Shemso Çelës.
16. Shtëpia e Muhamet Ismail Tufës.
17. Shtëpia muze e Hasan Çelës.
18. Dyqani Flora.
19. Shtëpia muze e Haxhi Qamilit, Sharrë.
20. Shtëpia ku u mbajt Konferenca e Pezës.

Elbasan

1. Banesa e Ram Karagjozit.
2. Banesa e Qamil Zhgunit.
3. Banesa e Ali Dishës.
4. Shtëpia e Konferencës së Labinotit.

Gramsh

1. Kasollja e Galigatit.

Librazhd

1. Banesa e Zyra Koçit.
2. Shpella e Guri Muzhaqit.

Pogradec

1. Banesa e Maro Mokrës.

Korçë

1. Shkolla e vjetër në fshatin Panarit.
2. Shkolla në fshatin Kucakë ku ka qëndruar Shtabi i Përgjithshëm.
3. Shtëpia ku u krijua Qarkori i Partisë.
4. Shtëpia e Priftit, Ziçisht, Devoll.

Vlorë

1. Shtëpia e Feti Elmazit në Rramic.
2. Banesa e Islam Gjonit.
3. Muzeu në fshatin Tërbaç.
4. Banesa e Murat Xhelilit.
5. Shtëpia muze e vëllezërve Nushi.
6. Shtëpia e Halim Xhelos ku u themelua Komiteti Qarkor Rinor.

Tropojë

1. Lëndina e Dragobisë ku Enver Hoxha ka zhvilluar bisedë me banorët e zonës.

Shkodër

1. Qarkori i Partisë.

Skrapar

1. Shtabi i ushtrisë në Helmës.
2. Shtëpia ku punoi Enver Hoxha në Helmës.

Gjirokastrë

1. Shtëpia ku u krijua Komiteti Qarkor i Partisë.

IV. Miratohet ndryshimi i emërimit të monumenteve historike, pasi këto monumente nuk ruajnë vlera historike por arkitekturore. Bazuar në nenin 31, pika 2, të të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve i propozon Ministrin të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ndryshimin e emërimit.

Si më poshtë vijon:

1. Shtëpia ku u krijua Komiteti Qarkor i Partisë, Roshnik. **Në Banesa në Roshnik.**
2. Banesa ku ka ndenjtur Shtabi i Përgjithshëm Vithkuq. **Në Banesa e Ristanëve.**
3. Godina e Liceut ku Enver Hoxha ka zhvilluar aktivitetet. **Në Godina e Liceut Korçë.**

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR



SEKRETAR I K.K.R.
PROF. DR. APOLLON BAÇE

